



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0780**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje ngalsa Hasani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE)“N.P.T. " Bajra ""- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, KUVENDI KOMUNAL I KLINËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.4- Mbjellëse për misër” me nr. të prokurimit: "634-23-1991-1-2-1" ,me datën 11.01.2024, mori këtë:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa nr. 2023/0780, e Operatorit Ekonomik N.P.T. "Bajra", datës, 11/10/2023, kundër” Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” AK- Komuna e Klinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mekanizëm bujqësor; Lot 1.Multikultivator dhe Lot 4.Mbjellse për misër” aktiviteti i prokurimit: "634-23-1991-1-2-1".
2. Anulohet, “Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues “ i datës 06.10.2023, i AK , Komuna Klinës për ” Lot 1. Multikultivator” për aktivitetin e prokurimit numër; 632-23-7962-1-2-1, dhe lënda për Lot 1., kthehet në Rivlerësim.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE “N.P.T. "Bajra”,” sipas paragrafi 4, të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*-Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Kuvendi Komunal i Klinës, në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 10.03.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë: 03.04.2023. Me datë 06.10.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: " Furnizim me mekanizëm bujqësor Lot.1- Multikultivator Lot.4-

Mbjellëse për misër” me nr. të prokurimit: "634-23-1991-1-2-1", ku është rekomanduar për kontratë, OE “N.P.T. Haxhijaha Shpk Rahovec ", për Lot 1.

Me datë 01.09.2023 , OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim, me datë 08.09.2023, (AK) Komuna e Klinës, aprovon si pjesërisht te bazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik “OE “N.P.T. " Bajra "- Prishtinë, për aktivitetin e prokurimit të shënuar si me lart.

OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese në OSHP me numër të protokollit 0780/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 107,000.00 €.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 02.11.2023 me raportin e ekspertizës. AK Komuna e Klinës, nuk është deklaruar se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq , OE “N.P.T. " Bajra "- Prishtinë , me datën 07.11.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e Ekspertit shqyrtues.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

*-Administrimi dhe vlerësimi i provave-*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Pretendimet ankimore të OE “N.P.T. " Bajra "- dhe përgjigjet e ekspertit shqyrtues sipas raportit 780/2023, i datës,02.11.2023.

Pretendimi nr.1 OE ankues pretendon se AK, pas kthimit të procesit në rivlerësim më datë 06.10.2023 përmes sistemit të prokurimit kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e dhënë se bashku me njoftimin se jemi shpërblyer me kontratë për LOT 4 ndërsa për LOT 1 ne si operator ekonomik përveq që pjesëmarrës në këtë aktivitet kemi qenë edhe parashtrues të kërkesës për rishqyrtim nuk kemi pranuar letër për tenderuesin e eliminuar fare (vendimi i bashkëngjitur në këtë ankesë). Shkelje kjo e radhës nga autoriteti kontraktues i cili përveq që ka rekomanduar sërish për kontratë operator ekonomik të papërgjegjshëm nuk e ka dërguar as formularin B42 për LOT 1 dhe BAJRA NPT.

Me datën: 20.10.2023, eksperti shqyrtues, i është drejtuar me shkrim autoritetit kontraktues, për te sqaruar faktin se a e është njoftuar OE ankues me letër standarde, ndërsa ka pranuar përgjigje si ne vijim;”O.E në fjale është i pa suksesshëm për Lot.1 pasi nuk ka qene oferta e përgjegjshme me çmimin ma të lire. Për këtë arsye nuk ka pranuar letër për te eliminuar” .

Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimi i OE ankues qëndron për faktin se autoriteti kontraktues edhe ne përgjigjen e datës 20.10.2023 e pranon faktin se nuk e ka njoftuar OE ankues me letër standarde, andaj mos dërgimin e letrës standarde te tenderuesit e konsideroj si shkelje procedurale, konkretisht nenit 54 te LPP-se dhe njeherit i rekomandoje AK-se, qe ti njoftoje operatoret ekonomik pavarësisht faktit se janë te pasuksesshëm, prandaj eksperti shqyrtues e konsideron shkelje te dispozitave te paragrafit 1.3 te nenit 54

te LPP-se.”1.3. në rast të një tenderuesi të pa-suksesshëm, që ka paraqitur tender të përgjegjshëm, njoftimi do të saktësojë karakteristikat dhe përparësitë përkatëse të tenderit fitues si dhe emrin e tenderuesit fitues”.

Pretendimi nr. 2. OE ankuese pretendon se: Ankesë Nr.1. LOT 1 -Blerje e Multikultivatorëve Neni 1 – Qëllimi Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi Autoriteti Kontraktues – nuk ka trajtuar në parim Udhëzuesin 001/2023 dhe LPP. Neni 7 i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Ne si operator ekonomik konstatojmë që kjo dispozitë e LPP-së është shkelur nga Autoriteti Kontraktues i cili nuk ka trajtuar në parim Udhëzimin 001/2023 dhe LPP-në. Autoriteti Kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. O.E. i rekomanduar për kontratë për LOT 1 është operator i papërgjeshëm i cili ka dërguar deklaratën e specifikacionit pa bashkëngjitur Specifikacionin Teknik ashtu si e kërkon ligji dhe udhëzimi i prokurimi publik. Sipas UDHËZUES Nr. 001/2023 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, specifikacioni teknik është kërkesë ligjore pa të cilin dokument tenderi duhet refuzuar pa kërkuar informacion të mëtejshëm. Pra, në këtë pikë kemi shkelje të ligjit nga ana e autoritetit kontraktues i cili ka rekomanduar për kontratë Haxhijaha SHPK – LOT 1 duke qenë i papërgjegjshëm: shih tere ankesën me foto ne dokumentin ankese: Kërkesa për specifikacion teknik të detajuar duhet dërguar edhe atëherë kur është dërguar katalogu – dhe kjo është po ashtu e përcaktuar me ligj dhe udhëzimin administrativ 001/2023 në të kundërtën tenderi duhet të refuzohet menjëherë pa kërkuar informacion të mëtejshëm: shih tere ankesën me foto ne dokumentin ankese. 8.2 “Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përzgjedhjes”. Kriteret e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike dhe nisur nga këtu shihet që në të dy LOT-et janë rekomanduar për kontratë operator ekonomik që nuk kanë përmbushur as kërkesat minimale të vendosura në FDT. Ankesë Nr.2. LOT 1 - Blerje e moto-kultivatorëve Kërkesë e FDT-së ka qenë periudha e gradacionit dhe jetëgjatësisë ndërsa O.E. i rekomanduar për kontratë për LOT 1 ka dërguar deklaratë për jetëgjatësinë të nënshkruar nga vet ai (operatori). Jetëgjatësia është një element shumë i rëndësishëm për pajisjen të cilin garanci mund t'i jap vetëm prodhuesi dhe në asnjë mënyrë si garancion i vlefshëm nuk mund të pranohet garancioni i jetëgjatësisë së dhënë nga një operator i cili thjeshtë vetëm e tregton pajisjen. Në dokumentin “Katalog” të prodhuesit BARBAROS me të cilën markë ka ofertuar OE Haxhijaha SHPK nuk shihet të jetë cituar ndokund pjesa e jetëgjatësisë andaj konstatojmë se dokumenti I dërguar nga ky O.E. është I papranueshëm dhe në mungesë të dokumentit të drejtë/korrekt të dërguar tenderi do të duhej të refuzohej dhe në asnjë mënyrë nuk do të duhej të kalonte në fazat tjera të vlerësimit të ofertave, kjo vlen edhe për procesin në fazat e rivlerësimit. Pra, edhe në këtë pikë shohim të ketë shkelje ligjore nga ana e autoritetit dhe atë Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Ndërkohë që ne si operator pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi kemi dërguar katalogun e prodhuesit STIHL në të cilin nga vet prodhuesi është cekur periudha e jetëgjatësisë. Për pjesën e garancionit është gjë tjetër kjo dhe këtë mund t'a marr sipër edhe vet operatori por Jetëgjatësinë në asnjë mënyrë – nuk është në të drejtën dhe as kompetencën tonë si operator. Fakt. 1. Deklarata mbi Garancionin me vulë dhe nënshkrim të OE të rekomanduar për kontratë: - Shih ankesën ne tërësi me foto bashkëngjitur. Ndërsa ne kemi dërguar katalogun e prodhuesit në të cilin figuron garancioni për pajisjes dhe jetëgjatësinë: Shih ankesën ne tërësi me foto bashkëngjitur.

Eksperti teknik vlerëson se pretendimi ankimore është i bazuar sepse ne katalogun e prodhuesit BARBAROS nuk shihet jetëgjatësia e mekanizmit bujqësor multikultivator.

Pretendimi nr. 3. OE ankuese pretendon se: Ankesë Nr.3. LOT 1 - Blerje e multikultivatorëve, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë për LOT 1 Blerja e multikultivatorëve ka ofertuar multikultivator 7.1HP te prodhuesit Barbaros-Turqi por kjo kompani nuk prodhon asnjë model te multikultivatoreve me këtë fuqi. Ne katalogun dhe website te prodhuesit (shih ne dokumentin ankese linkun e faqes pasi sistemi nuk po e ruan faktin 7.4 kur po vendoset linku nga website) shihen multikultivator me fuqi 5.5HP, 6.5HP, 7.0HP, 8.5HP, 12HP dhe 17HP ndërsa ne kategorinë e multikultivatoreve benzine modeli me fuqinë me të madhe është modeli me 6.5HP (vlen për të gjitha modelet e multikultivatorëve pa u përcaktuar për numër

të shpejtësive) ndërsa në kategorinë e multikultivatorëve me naftë, multikultivator me 7.1HP nuk ka asnjë model dhe kjo bënë të nënkuptohet bazuar edhe nga numrin I shpejtësive 3 1 që fjala mund të jetë për multikultivator me fuqi prej 7.0HP. Duke mos cekur modelin e ofertuar, derivatin dhe duke pa qe ekziston dis'harmoni ndërmjet fotografisë dhe të dhënave teknike që në pjesën dërmuese janë një përshkrim nga FDT supozojmë se kemi të bëjmë me manipulim të katalogut të dërguar. Madje mos përcaktimi I derivatit krijon dyshime shtesë që tërë kjo ofertë është e menduar për të vënë në lajthitje autoritetin dhe e menduar për të manipuluar. Në vijim mund të shihni pamje nga katalogu I prodhuesit ku shihen gjitha modelet dhe bendet që I prodhon ky prodhues (nga faqe 84 deri në 92 I gjeni të llastuara në linkun e vendosur si më lartë gjitha llojet e multikultivatorëve të këtij prodhuesi): Pamje nga katalogu mund te shihni duke shikuar ne tërësi ankesën me vule dhe nënshkrim .

Shtrohen pyetjet: · Si komisioni vlerësues ka bërë vlerësimin e ofertës së këtij operatori duke mos përmbushur kriteret bazë sipas FDT-së? · Si ka mundësi që të nxirret një vendim I dytë për OE të papërgjegjshëm I cili as model e as brenda me të cilin ka ofertuar nuk ka treguar? · Si ka mundësi që një prodhues siç është Barbaros të dërgoj një katalog sic është katalogu I prezantuar? Një katalog pa ngjyra, pa renditje konceptuale të detajeve teknike. Shih në vijim renditje për RPM konform shpejtësive: shih pamje ne dokumentin ANKESE ! Hapësira ndërmjet tyre duke futur detaje teknike tjera është një tentativë për të hutuar ndoshta dhe komisionin vlerësues për t'i kaluar këtë pjesë pa u vërejtur por kjo mund të ndodhte ndoshta herën e parë por jo edhe gjatë rivlerësimit për të dytën herë. Me pak kërkime në internet mund të shihni dhe të vërtetoni saktë pretendimet tona ankimore.

Pastaj të një pas njëshme janë detaje tjera teknike të cilat ose nuk përmbushen ose janë një përshkrim nga FDT-ja I vendosur në katalogun e prodhuesit me kërkesë të operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi të cilave vetëm ju kanë vendosur vulën që për NE nuk ofron asnjë siguri të vetme. Po të ishte ndryshe citojmë sërish do të tregohej brendi/marka, modeli mbi të gjitha do të ishte një katalog me plotë kuptimin e fjalës katalog nga prodhuesi. Është kërkuar emetimi i gazit të jetë 811,46 g/kWh, modeli I ofertuar nga operatori ekonomik nuk e ofron këtë specifike teknike. Emetimi I gazit është një faktor shumë me rëndësi për njeriun dhe mjedisin. Specifikimi teknik - do të thotë në raste të kontratave të punëve publike, tërësia e përshkrimeve teknike të përmbajtura veçanërisht në dokumentacionin e tenderit, që përkufizojnë karakteristikat e kërkuara të një materialit, produktit ose furnizimit që i mundëson llojit të punës, materialit, produktit, furnizimit ose shërbimit që të përshkruhet në mënyrë që të plotësoj nevojat e paracaktuara nga autoriteti kontraktues. Këto karakteristika do të përfshijë nivelet e performancës mjedisore, projektimin për të gjitha kërkesat (duke përfshirë qasjen për persona me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimit të konformitetit, treguesin e zbatueshmërisë, aspektin e sigurisë apo dimensionet, duke përfshirë procedurat në lidhje me sigurinë e kualitetit, terminologjisë, simboleve, metodave testit dhe testimit, ambalazhimit, shënimit dhe etiketimit dhe proceset dhe metodat e prodhimit.

Eksperti teknik vlerëson se pretendimi ankimore është i bazuar sepse ne katalogun e prodhuesit BARBAROS nuk shihet modeli i Multikultivatorit te kërkuar sipas specifikimit teknik te detyrueshëm.

Pretendimi nr. 4 OE ankues thekson se është i rëndësishëm faktori që tregon emetimin e gazit. Përgjegjësia sociale është një element shumë i rëndësishëm të cilin duhet t'i kemi parasysh të gjithë dhe bazuar në këtë autoriteti ka përpiluar kërkesat të tilla por si mund ti mbyll sytë komisioni vlerësues para një kriteri kaq domethënës dhe një morie mos përmbushjes tjera këtë nuk e kemi të qartë! Dridhjet e multikultivatorit në katalogun e operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate janë paraqitur 6.5m/s2 – 7.0m/s2 , është një përshkrim I të dhënave nga FDT pasi asnjë multikultivator i prodhuesit Barbaros nuk ofron multikultivator që ka dridhje të lejuara të multikultivatorit brenda intervalit të përcaktuar prandaj është përshkruar prej / deri një specifike teknikë që bazuar në direktivat prodhuese të makinerive duhet të ketë një normë e jo lartësi prej – deri, kështu ka ndodhur edhe me detaje tjera teknike dhe jo vetëm: Pozicionet siç janë faktori i pasigurisë, niveli i presionit te zërit, niveli i fuqisë së zërit, boshti vertikal (shih katalogun si në vijim) dhe aftësia e multikultivatorit që të arrijë vendet me pjerrtësi deri në 15 (26.8%) – të gjitha këto serish janë një përshkrim I të dhënave nga FDT ne katalog. Nuk ka mundësi që prodhuesi të mos i dije vlerat e sakta për dridhje, nivel të presionit të zërit apo dhe fuqisë së zërit saktë po

të ekzistonte si model ky multikultivator. Këto specifika janë të dhëna teknike për të cilën duhet tregohen vlera saktë dhe këtë nuk ka se si mos ta dijë prodhuesi por kjo ndodh kur ofertohet me multikultivator të përshtatur, që nuk ekziston, që nuk ka model, që nuk ka emër. Vijnë mos përmbushjet tjera: Është kërkuar që rrotat të jenë me mbulesë ndërsa modeli i prezantuar në foto shihet që nuk ka mbulesë të rrotave. Është kërkuar të jetë me filtër të ajrit të lagësht për kushte pluhuri ndërsa modeli I ofertuar nuk e plotëson as këtë kriter. Në vijim mund të shihni “katalogun e prodhuesit” të dërguar nga O.E. – LOT 1 nga i cili mund të vëreni qartë që ky katalog përmban të dhëna jo reale dhe në shumë pika mos përmbushëse krahasuar me kërkesat e vendosura në FDT. Shih katalogun nga operatori i rekomanduar ne dokumentin bashkëngjitur

Ekspertit teknik vlerëson se pretendimi ankimore është i bazuar sepse ne katalogun e prodhuesit BARBAROUS nuk gjendet modeli me fuqi P=7.1 [HP] apo max P=8.0[HP] dhe shpejtësi 2+1, andaj nuk mund të vërtetohen parametrat tjerë teknik.

Pretendimi nr. 5. LOT 1 – Blerje e multikultivatorëve Me FDT është kërkuar të dërgohet deklarata e konfirmimit CE dhe standardet / direktivat prodhuese: Dir.2006/42/ECRS, 2014/30/EU, 2000/14/EC, 2000/14/EC dhe 2011/65/EU , vijon me pamje nga kërkesat ne fdt te cilat mund ti shihni ne dokumentin ankese te bashkëngjitur me pamje dhe detaje te bazuara ne gjetje/fakte. Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dërguar Certifikatë /Deklaratë konfirmimiti në të cilën janë të prezantuara modele që nuk korrespondojnë me modelin me të cilin ka ofertuar ky operator ekonomik. Kjo forcon bindjet tona që modeli i ofertuar / paraqitur në këtë katalog nuk ekziston POR edhe po të “ekzistonte” nuk është aspak model konform standardeve të kërkuara e as specifikave të vendosura në FDT. Shihet qartë nga deklarata e konfirmimitit që vetëm brendi Bartech me disa modele te caktuara I këtij prodhuesi është me CE por që asnjëri nga modelet në këtë deklaratë nuk përafrohet me çfarë është kërkuar në FDT dhe kjo është arsyeja që operatori ekonomik nuk ka vendosur model në katalog por që në mënyra të ndryshme të paraqitjes së dokumentacionit është munduar të krijojë amulli dhe kjo nuk ka se si mos të jetë tendencioze – por që autoriteti kontraktues mbyll sytë para tërë këtyre fakteve dhe shkel ligjin për herë të dytë për ne si OE është e papranueshme. Nga certifikata e konfirmimitit shihet qartë që direktivat prodhuese 2014/30/EU, 2000/14/EC, 2000/14/EC dhe 2011/65/EU nuk zbatohen / plotësohen nga ky prodhues ashtu siç nuk plotësohet standardi EN 12096 i cili standard është i vendosur vet në “katalogun e prodhuesit” – Po të plotësohej si standard nga prodhuesi do të figuronte në CE – deklaratën konfirmimiti, ashtu siç është e rregulluar me rregulloret / direktivat për makineritë.

Ekspertit teknik vlerëson se Deklarata e Konformitetit e dorëzuar për prodhuesin BARBAROS MOTOR MAKINA SAN...është për multikultivatorët e modelit Bartech (200-300-300D-410-512-517-522), por asnjëri prej këtyre tipave nuk është sipas specifikacionit teknik të kërkuar ne dosjen e tenderit dhe pretendimi ankimore është i bazuar.

Eksperti Shqyrtues konstaton se bazuar në sqarimet e lartpërmendura, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues për LOT 1 të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

#### *-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e

prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, ka administruar si prova: Raportin e ekspertit shqyrtues, ankesa e Operatorit ekonomik “N.P.T. "Bajra”, Raportin e Vlerësimit Tenderëve i datës 16.10.2023, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës 06.10.2023, AK- Komuna e Klinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me mekanizëm bujqësor; Lot 1.Multikultivator dhe Lot 4.Mbjellse për misër” aktiviteti i prokurimit: "634-23-1991-1-2-1.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit ekonomik ankues “N.P.T. "Bajra”, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit ekonomik “N.P.T. "Bajra”, janë konstatuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues konstaton se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues/teknik lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të eliminohen shkeljet e konstatuara sipas raportit të ekspertit shqyrtues dhe teknik.

Andaj Paneli përfundimisht ka vendosur për të aprovuar ankesën e Operatorit ekonomik “N.P.T. Bajra”, të anulohet “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 06.10.2023, për ” Lot 1. Multikultivator” për aktivitetin e prokurimit numër; 632-23-7962-1-2-1, dhe lënda për Lot 1, kthehet në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës së Operatorit ekonomik “N.P.T. Bajra”,vendos t’i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga OE ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - N.P.T. " Bajra "**
- Arkivës së OSHP-së: